



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:242603

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06326049

2023:242604

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses I.K me adresë në fsh. S... -K.Ferizaj, me nr. personal të cilën e përfaqëson av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson L.M. nga Shtimja, për shkak të shpërblimit të licencimit, me vlerë të kontestit 1328.40 €, jashtë seancës më dt. 21.10.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.K me adresë në fsh. S... -K.Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit që paditëses I.K në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit (licencimit) të ia kompensojë shumën dhe atë nga data 01.02.2021 deri më datë 31.01.2023 për 24 muaj, diferenca në shumën totale prej 1328.40€ (njëmijë e treqind e njëzetë e tetë euro e katërdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 09.11.2023) e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.
- III. DETYROHET e paditura Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit që paditëses I.K të ja kompensoj shpenzimet procedurale në lartësinë prej 125,00€ në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësja përmes përfaqësuesit së tij me autorizim av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj, në këtë gjykatë më datë 09.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna Shtime – Drejtoria

e Arsimit, për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësën me Licencim, e në të cilën padi ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në Shkollën e Filllore të Mesme të Ultë "S...." në Fsh-R....K.Shtime, në pozitën mësues klase, me kontratë pune e licencuar – licenca nr.100021050, datë 20.05.2014. Në parashtrësën për precizimin e padisë përfaqësuesi i paditëses av. Xhavit Mahmuti nga Ferizaj ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura Komuna Shtime-Drejtoria e Arsimit që paditësës I.K në emër të kërkesës për kompensim të diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit (licencimit) të ia kompensojë shumën dhe atë nga data 01.02.2021 deri më datë 31.01.2023 për 24 muaj, diferenca në shumë prej 1328.40€ për 24 muaj, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë (datë 15.06.2021) e deri në pagesën definitivën afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet procedurale në lartësinë prej 125,00€, edhe atë 104,00€ për hartimin e padisë dhe 21,00€ për pagesën e taksës gjyqësore.

E paditura Komuna Shtime, përmes përgjigjes në padi të dt. 21.06.2024 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin se padia e dt. 09.11.2023 dhe kërkesëpadia janë të parashkruara, po ashtu edhe kontrata kolektive e arsimit e vitit 2017, 2021 me nuk është në fuqi. Ka shtuar se Komuna nuk ka mundur të krijojë vijë buxhetore për të kryer këto pagesa që i parasheh kontrata kolektive e arsimit. Për të gjitha këto arsye konsideron se padia dhe kërkesëpadia nuk kanë baze ligjore. Andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Kontratë pune për mësimdhënës me nr. prot. ..., e datës, Diploma e Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Edukimit, me nr., e datës ..., Lista e pagave e lëshuar nga BRK, e muajit qershor 2021, mars 2022, Licenca e mësimdhënësit nr....., e datës 20.05.2014.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Nga Kontrata e punës për mësimdhënës, me nr. prot., e datës gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me K.Shtime-Drejtorinë Komunale të Shtimes në

Shtime edhe atë duke filluar nga data në detyrat e punës mësuese klase, në shkollën fillore e mesme e ulët “....”, në fshatin reçak K.Shtime.

Nga licenca e mësimdhënësës me nr....., e datës gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja është licencuar nga MASHT në Prishtinë më datën

Nga Diploma e UP-Fakultetit të Edukimit e dt., gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka mbaruar studimet në Universitetin e Prishtinës dhe ka marrë kualifikimin Bachelor i Programit Fillor.

Nga Lista e pagave e lëshuar nga BRK e muajit qershor 2021, mars 2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësja pagën bazë e ka pasur 421,00€ dhe paditëses për shkak të kualifikimit ju ka paguar shuma prej 58.32 euro.

Sipas nenit, 8 parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”.

Kurse sipas nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të vitit 2021 të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), është paraparë se: “Me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar bazuar në UA nr. 5/17. Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale si vijon: 1.1 mesimdhënës me licencë të karrierës 10% e pagës bazë, 1.2 mesimdhënës me licencë të avancuar 10% e pagës bazë, 1.3 mesimdhënës me licencë mentor 15 % e pagës bazë, 1.4 mesimdhënës me licencë meritore 15 % e pagës bazë.”.

Vendimi i Qeverisë, Nr.... i datës shprehimisht në pikën 4.3 parasheh se; mësimdhënësit, drejtorët dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë një rritje page bazë prej 27%.

Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës nr. 214/2023, i datës 09.10.2023, në pikën I. të tij ka paraparë se: “Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësës është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, punon si në detyrat e punës mësuese klase, shkolla fillore e mesme e ulët “....” në fsh. R...-K.Shtime, ka të kryera studimet themelore universitare në Universitetin e Prishtinës, ka marrë titullin Bachelor i Programit Fillor dhe është licencuar si mësimdhënëse e karrierës nga MASHT, pagën bazë e ka në lartësi prej 421,00 euro. Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata vlerëson se paditësës i takon kompensimi i pagesës për gradim–diferencë për shkak të kualifikimit (licencimit), ashtu që gjykata të njëjtës i ka aprovuar shumën e kërkuar në emër të shpërblimit në licencim-gradim dhe atë nga data 01.02.2021 deri me datë 31.01.2023 për 24 muaj, ku paga bazë në arsimin parafillor është 421€, duke llogaritur pagën bazë në shumë prej $421 \times 27\% = 113.67\text{€}$ ndërsa ka realizuar për kualifikim shumën prej 58.32€ pra prej shumës $113.67 - 58.32 = 55.35\text{€}$, diferenca në shumë prej $55.35 \text{€} \times 24 \text{ muaj} = 1,328.40\text{€}$. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë për shumat e gjukuara dhe aprovuara sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vendosur pa nxjerrë ekspertizë përkatëse sepse për palët ndërgjyqës nuk ka qenë kontestuese lartësia e kërkesëpadisë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku është thirr në parashkrim të kërkesës se paditësit, mirëpo, sipas gjykatës një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi paditësi padinë e ka paraqitur në gjykatë më 09.11.2023, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës, pasi që sipas nenit 87 të këtij ligji, në mënyrë shprehimore është paraparë se: “Të gjitha kërkesat ngamarrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjessë kërkesës”. Andaj nga këto arsye rezulton se padia e paditësit është parashtruar brenda afatit ligjor prej 3 viteve, dhe rrjedhimisht kërkesëpadia e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura.

Nga se u tha më lartë, duke pas parasysh faktin se paditësit i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së tij lidhur me kërkesën e parashtruar, i njëjti si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkoj përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sipas nenit 245 të Ligjit nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Andaj, duke pas parasysh të cekurat më lartë, gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendosjen për kamatën, gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, por që e ka marrë konsideratë edhe Mendimin Juridik për kamatën (lidhur me ligjin e aplikueshëm, lartësinë dhe periudhën e llogaritjes) të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, nr.265/2020, të datës 02.12.2020.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë irrelevante në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata është bazuar në dispozitat e nenit 452, par. 2 dhe 463 të LPK-së dhe TOAK. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, e të cilat shpenzime përfshijnë: për përpilimin e padisë në shumën prej 104,00€, si dhe për taksë gjyqësore shumën 21,00€.

Nga të cekurat më lartë, e konform nenit 398 të LPK, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

2023:242604, datë 21.10.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

Udhëzimi mbi mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.